



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUAR I KUALIFIKIMIT

NR. 6 AKTI

NR. 37 VENDIMI

Tiranë, më 16.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Olsi Komici	Anëtar
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 12.07.2018, ora 12:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gani Dizdari**, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurë nga avokat Sokol Hazizaj.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, C, D, DH, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, (referuar më poshtë Kushtetuta);

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Roland Ilia, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në dy kriteret e vlerësimit, atë pasuror dhe të figurës, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Gani Dizdari, është anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi dhe në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” (më poshtë referuar si “Komisioni”), çështja e tij iu shpërnda me short trupit gjykues të përbërë nga komisionerët: Roland Ilia relator, Pamela Qirko kryesues, Olsi Komici anëtar.

Komisionit i Pavarur i Kualifikimit bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 administroi raportet e hartuara nga institucionet mbështetëse: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) pas kryerjes së procedurave të kontrollit për vlerësimin e pasurisë, nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 06.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016,

nëpërmjet shkresave nr. *** prot., datë 08.01.2018; nr. *** prot., datë 07.05.2018 dhe nr. *** prot., datë 11.05.2018, ka dërguar raportet për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 12.12.2017. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Trupi gjykues në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 14.06.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht dhe njoftimin subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 19.06.2018 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Z. Dizdari u njoh me aktet e dosjes, më datë 28.06.2018, dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtimeve dhe provave të reja, më datë 12.07.2018. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi ta ftojë atë në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 10.07.2018. Seanca u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 12.07.2018, ora 12:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti nga përfaqësuesi me prokurë, avokat Sokol Hazizaj, i cili shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, avokati i subjektit të rivlerësimit kërkoi konfirmimin e të përfaqësuarit në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Gani Dizdari ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së, në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) Deklarimet e personave të tjerë të lidhur;

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 31.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

- a) **Apartament banimi**,¹ me sipërfaqe 95.7 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurisë ****, Vol. ***, Fq. ****.

(Burimi sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore me kontratën e datës 14.04.1994, bërë nga Ndërmarrja Komonale), në vlerën 24.826 lekë. Nga kjo pasuri zotëron 75% të saj).

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë² (referuar si “ZVRPP”), me shkresën, nr. *** prot., datë 29.12.2017, konfirmon bashkëpronësinë e subjektit të rivlerësimit, z.

¹ Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës:

- Kontratë Shitblerje nr. *** rep., *** kol., datë 26.04.1994, apartament me sipërfaqe 95.7 m², përfituar nga privatizimi;
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 06.03.2007, “Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë”;
- Vërtetim lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, nr. *** prot., datë 07.12.2016;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 16.05.2007, për apartamentin me sipërfaqe 95.7 m², nga ku rezulton se z. Gani Dizdari zotëron ¾ dhe znj. A.D. zotëron ¼ pjesë.

²Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar ZQRPP-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari, dhe personave të lidhur me të.

Gani Dizdari me znj. A.D., për pasurinë me nr. ***, Vol. ***, Fq. ***, ZK. ***, lloji i pasurisë: apartament me sipërfaqe. 95.7 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë;

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike³ (referuar si “OSHEE”), me shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikon se në emër të shtetasit Gani Dizdari, rezultojnë 2 kontrata për faturim me energji elektrike njëra prej të cilave është për apartamentin me adresë: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, me status “Kontratë Aktive” me datë hapje 10.10.1997;

Ujësjetës Kanalizime Tiranë⁴ (referuar si “UKT”), me shkresën me nr. *** prot., datë 06.02.2018, nuk konfirmon asnjë kontratë për furnizim, në emër të subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

b) Apartament banimi,⁵ me sipërfaqe 69.7 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurisë ***, Vol. ***, Fq. ***. Deklaruesi zotëron 50% të kësaj pasurie sipas Deklaratës-Vetting, shtojca 2. Kjo pasuri është blerë me kontratën nr. *** kol., nr. *** rep., datë 09.02.1998, në vlerën 1.850.000 lekë, nga znj. D.D. (bashkëshortja e ndjerë e subjektit);

Hetimi i kryer nga Komisioni:

ZVRPP Tiranë⁶, me shkresën me nr. *** prot., datë 29.12.2017, konfirmon bashkëpronësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari me znj. A.D., për pasurinë me nr. ***, Vol. ***, Fq. ***, ZK. ***, lloji i pasurisë: **apartament**, me sipërfaqe. 69.7 m², ndodhur në Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë;

OSHEE⁷, me shkresën nr. *** prot., datë 12.01.2018, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikon se në emër të shtetasit Gani Dizdari, rezultojnë 2 kontrata për faturim me energji elektrike

³ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, OSHEE-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi çdo kontratë furnizimi me energji elektrike të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

⁴ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar UKT-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

⁵ Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëngjitur Deklaratës-Vetting:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.02.1998, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m², blerë nga znj. D.D., në shumën 1.850.000 lekë;
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 06.03.2007, me objekt: “Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë;
- Vërtetim lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, me nr. *** prot., datë 07.12.2016;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, më datë 05.06.2007, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m².

⁶ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar ZVRPP-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari, dhe personave të lidhur me të.

⁷ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, OSHE-s, me të cilën është kërkuar informacion mbi çdo kontratë furnizimi me energji elektrike të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

njëra prej të cilave është për apartamentin me adresë: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë me status “Kontratë Aktive” me datë hapje 10.10.1997;

UKT⁸, me shkresën me nr. *** prot., datë 06.02.2018, nuk konfirmon asnjë kontratë për furnizim me adresë përdoruesi për në këtë pasuri.

Analiza Financiare:

- Deri në vitin 1998 subjekti kishte në pronësi dy apartamentet e cituara më sipërfaqe me vlera 24.826 lekë dhe 1.850.000 lekë. Në total vlera e pasurisë së vënë deri në fund të vitit 1998 është **1.874.826 lekë**.
- Të ardhurat e dokumentuara nga pagat për subjektin dhe bashkëshorten nga viti 1981 deri në vitin 1998, vit në të cilin është blerë apartamenti, janë në shumën **2.391.593 lekë**.

Periudha	Subjekti	B/SH	TOTAL: Subjekti + B/SH
16.12.1981-31.12.1993	205.878	-	205.878
1994	193.613	46.907	240.520
1995	286.994	56.687	343.681
1996	380.554	73.630	454.184
1997	396.312	64.370	460.682
1998	587.993	98.655	686.648
TOTAL	2.051.344	340.249	2.391.593

Subjekti deklaron të ardhura për periudhën 1981-1993, në shumën 1.138.320 lekë, ndërkohë që nga dokumentet e sigurimeve shoqërore, subjekti për këtë periudhë ka pasur paga neto në shumën **205.878 lekë**.

Është pyetur subjekti për këtë diferencë. Sipas shkresës nr. ***, datë 12.02.2018, subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Pretendimi juaj se nga dokumentet që dispononi unë jam paguar 205.878 lekë, për këtë periudhë mendoj se është i pa sakatë mbasi afërsisht këtë shumë unë e kam marrë për 2 vjet, atëherë për 10 vitet e tjera në vazhdim ku ndodhet paga ime kur dihet se unë nuk jam shkëputur asnjë moment nga puna. Theksoj se në këto vite të paktën nga 1982 - 1991 leku ka qenë pa inflacion i pa zhvlerësuar dhe nga një përlllogaritje e thjeshtë kur paga ime ka qenë 8.000 lekë, në muaj e më vonë 9.000 e 10.000 lekë në muaj, del qartë se deklarimi im ka qenë relativisht i saktë”*.

Saktësojmë se pagat në periudhën 1981-1990 kanë qenë 800 lekë/muaj dhe jo 8.000 lekë/muaj, sikurse argumenton subjekti, prandaj pretendimi i tij nuk qëndron.

Diferenca e mbetur (2.391.593 lekë - 1.874.826 lekë) për shpenzime të tjera për periudhën 1981-1998 është në shumën **516.767 lekë**. Kjo shumë nuk është e mjaftueshme për jetesë.

Nga Deklarata-Vetting e depozituar nga vetë subjekti, nuk rezulton që të jetë deklaruar burimi i krijimit për këtë pasuri. Subjekti ka deklaruar që është blerë nga ish-bashkëshortja e tij, pa specifikuar burimin.

⁸ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar UKT-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës⁹ dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016¹⁰.

Në përfundim të hetimit vërehet se subjekti i rivlerësimit:

- Ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie;
- Ka dhënë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave me të cilat janë blerë këto pasuritë e paluajtshme;
- Ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me të ardhurat e realizuara në vite.

- Apartment banimi**,¹¹ me sipërfaqe. 63.08 m², ndodhur në Gjirin e Lalzit (sipërfaqe shkalle 7 m² dhe sipërfaqe ballkoni 16.78 m²), sipërfaqe totale e apartamentit 86.86 m², regjistruar në zonën kadastrale, nr. ***, nr. pasurie ***, Vol ***, Fq. ***, me kontratë shitblerje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2013 (në vlerën 3.300.000 lekë)¹²;
- Tokë arë**¹³, në fshatin Mjull, Bathore, me sipërfaqe.1000 m², e ndodhur në ZK. ***, nr. pasurie ***, vol ***, Fq. ***, blerë me kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 15.01.2009, në shumën 344.000 lekë (zotëron 100% të kësaj pasurie);
- Depozitë bankare në shumën 1.843.006 lekë¹⁴. Subjekti ka hapur depozitë bankare në datën 30.06.2011, në “Credins Bank”, në shumën 1.500.000 lekë. Duke shtuar interesat bankare, më datë 28.12.2016, kjo shumë ka arritur në vlerën 1.843.006 lekë;
- Depozitë në shumën 39.966 USD¹⁵. Subjekti ka deklaruar depozitë bankare të çelur më datë 09.07.2007, në shumën 35.000 USD, e cila më datë 13.07.2010, është shtuar me 4.966 USD (të ardhura nga interesat) duke u bërë në total 39.966 USD. Nga kjo sasi 25.000 USD janë shpenzuar për rikonstruksion të banesës në adresën: Rr. “***”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë;
- Depozitë në shumën 60.000 lekë¹⁶. Më datë 22.07.1999, në ish-Bankën e Kursimeve në Tiranë, me nr. kartel ***, e cila ka kaluar në “Raiffeisen Bank” (subjekti zotëron 100% të depozitës);

⁹Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni D, pika 3, fjalia e parë.

3. “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave”.

¹⁰Neni 32, pika 1, ligji nr. 84/2016;

1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

¹¹ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës:

- Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., ***kol., datë 15.11.2013, apartment me sipërfaqe. 63.08 m²;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. ***, datë 11.12.2013, për apartamentin me sipërfaqe 63.08 m² + kartela e pasurisë.

¹²Çmimi i apartamentit është bërë në disa këste dhe në disa vite në vijim.

¹³Subjekti për këtë pasuri i ka bashkëngjitur deklaratës:

- Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.01.2009, për pasurinë arë me sipërfaqeërfaqe1.000 m²;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. ***, datë 11.12.2013, për apartamentin me sipërfaqe. 63.08 m².

¹⁴ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës, nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 28.12.2016, për gjendjen, datë 28.12.2016, në shumën 1.843.006 lekë.

¹⁵ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 28.12.2016. Rezulton tërheqje dhe derdhje në datat e deklaruara. Gjendja 0 lekë.

¹⁶ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës, fotokopje të librezës nga “Banka e Kursimeve”, nr. ***, për gjendjen 60.000 lekë, derdhur më datë 20.07.1999.

- f) Depozitë bankare në shumën 8000 USD¹⁷. Më datë 28.12.2016, ka depozituar në “Credins Bank”, shumën prej 8000 USD, sasi e mbajtur *cash* nga ana e subjektit të rivlerësimit që nga tërheqja e deklaruar më lart nga “Raiffeisen Bank”, datë 13.07.2010. (zotërim 100%);
- g) Gjendje bankare në shumën 1.655.574 lekë, në “BKT”¹⁸. Më datë 28.12.2016, në “BKT” ka mbetur gjendje, shuma 1.655.574 lekë, të derdhura nga paga dhe të pa tërhequra nga ana ime (zotërim 100%);

Në lidhje me pasuritë e deklaruar nga subjekti të cituara në pikat nga d) – i), në përfundim të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni vërehet se:

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga vetë ai dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.
- h) Depozitë në shumën 5.272 euro¹⁹. Më datë 07.09.2011, hapur depozitë në “Credins Bank” me 50 euro. Në këtë depozitë janë derdhur nga banka “ORD UNIVERSITAEKLINIKUM” Hamburg, Gjermani shuma 3.523 euro, si rezultat i kthimit nga mbyllja e llogarisë për kurimin në spital. Në këtë depozitë subjekti ka shtuar dhe shumën 1.453 euro (totali 5000 euro). Së bashku me interesat shuma shkon në 5.272 euro. Depozita zotërohet 100% nga subjekti.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

“Credins Bank”²⁰ me shkresën, nr. ***, datë 29.03.2018, konfirmon ekzistencën e depozitës 24 mujore, me balancë në shumën **5.272** euro.

Subjekti në përgjigjet e pyetësorin standard, ardhur me shkresën nr. ***, datë 27.12.2018, në përgjigjen nr. 8, deklaroi se: “*Shërbimi mjekësor i marrë në Gjermani, ka kushtuar 15.000 euro*”. Ndërkohë që në “Deklaratën e Interesave Private Periodike” të vitit 2010, është deklaruar se ka kushtuar **10.270** euro.

Pas verifikimit financiar nga Komisioni, ka rezultuar se kjo llogari është hapur në vitin 2011 dhe nga analiza e situatës financiare të subjektit për këtë vit konstatohet se ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj.

Ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar burimin e kësaj depozite në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”. Në përgjigje të pyetësorit shtesë, nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar si burim për krijimin e kësaj depozite kontributi i “*njerëzve të mi, nipi, mbesa, etj*”, por pa dorëzuar dokumentacion provues për të mbështetur këtë deklaram. Nga ana e tyre nuk është konfirmuar fakti i mësipërm, duke mos

¹⁷ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës, nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 29.12.2016, për gjendje në këtë datë në shumën 8.000 USD.

¹⁸ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës, nxjerrje llogarie nga “BKT”, datë 28.12.2016, për gjendjen, datë 01.12.2016, në shumën 1.655.574 lekë.

¹⁹ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 28.12.2016, për gjendje në këtë datë në shumën 5.272 euro.

²⁰ Shih në dosje shkresën e Komisionit me nr. ***, datë 07.12.2017, drejtuar bankave, dhe shkresën nr. ***, datë 21.02.2018, drejtuar “Credins Bank”, me të cilën është kërkuar informacion bankar për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të kaluara tek subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016²¹. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- Ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie;
- Ka dhënë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie.

Pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur, e bija e subjektit të rivlerësimit:

Znj. A.D., e bija e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar pasuritë e mëposhtme:

- i) **Apartament banimi**,²² me sipërfaqe 89.16 m², blerë sipas kontratës së shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2013, me adresë: Rr. “***”, Shk. ***, Kati ***, Ap. ***, Tiranë², ZK. ***, nr. pasurie ***, Vol. ***, Fq. ***. Kjo pasuri është blerë nga shitësi shoqëria “***”, sh.p.k., për shumën 73.111 euro, dhe zotërohet 100% nga personi i lidhur, znj. A.D.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

ZVRPP Tiranë²³, me shkresën me nr. *** prot., konfirmon pronësinë e znj. A.D., për pasurinë, apartament me sipërfaqe 89.16 m², me adresë: Rr. “***”, Shk. ***, Kati ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurie ***, Vol. ***, Fq. ***, blerë sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2013.

Ministria e Drejtësisë/Zyra e Regjistrimit Noterial²⁴, me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2017, konfirmon aktin noterial të kontratës së shitblerjes, të kryer pranë noteres M.S.

OSHEE²⁵, me shkresën nr. ***, datë 06.02.2018, konfirmon se referuar sistemit të faturimit identifikohet 2 kontrata në emrin e znj. A.D., njëra në adresën: Rr. “***”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, me datë hapje 10.10.1997, dhe tjetra identifikohet në pasurinë e ndodhur në adresën: Rr. “***”, me datë hapje 06.05.2011.

²¹ Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 32, pika 4”

4. “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

²² Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratën:

- Kontratë shitblerjeje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2013, për apartamentin me sipërfaqe 89.16 m², blerë 73.111 euro nga znj. A.D.;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. ***, datë 01.03.2013, për këtë apartament në emër të shoqërisë “***” sh.p.k + praktika;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. *** + kartela e pasurisë, datë 30.12.2016, në emër të znj. A.D.

²³ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar ZQRPP-së me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

²⁴ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar Zyrës së Regjistrimit Noterial, me të cilën janë kërkuar të dhëna mbi pasuri të paluajtshme të përfituara nga një akt noterial i paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që disponojnë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të.

²⁵ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar OSHEE-së.

UKT²⁶, me shkresën nr. *** prot., datë 06.02.2018, konfirmon se në emër të znj. A.D. rezulton e regjistruar kontrata me nr. ***, për objektin me adresë: Rr. “***”, Tiranë, në kategorinë konsumatorë familjarë, ku rezulton se ka filluar konsumi i ujit të pijshëm që në muajin nëntor 2011.

Analiza e provave:

Në “Deklaratën e Pasurisë Vetting”, sipas shtojcës 2, çmimi i shitjes së apartamentit të personit të lidhur, znj. A.D., në adresën: Rr. “***”, deklarohet në shumën **73.111** euro. Gjithashtu, dhe në kontratën e shitblerjes së pasurisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2013, çmimi i shitjes së pasurisë me adresë në Rr. “***”, Shk. ***, Kati ***, Ap. ***, Tiranë, me sipërfaqe. **89.16 m²**, ZK. ***, nr. pasurie ***, Vol. ***, Fq. ***, është **73.111** euro. Në kontratën e shitblerjes citohet se: *“Likuidimi i çmimit të kontratës është bërë jashtë kësaj zyre noteriale, në bazë të kontratës së sipërmarrjes që palët kanë lidhur paraprakisht ndërmjet tyre”*.

↓ Në lidhje me çmimin e deklaruar të apartamentit në Deklaratën e Interesave Private Periodike të vitit 2009, personi i lidhur, znj. A.D., ka deklaruar se apartamenti sipas kontratës së porosisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, ka çmim **94.000** euro, prej të cilave janë shlyer **40.000** euro, dhe ka mbetur pa shlyer kundrejt subjektit sipërmarrës detyrimi në vlerën prej **54.000** eurosh.

Më tej, në vitin 2010, është deklaruar se janë shlyer dhe **54.000** euro, pjesa e mbetur e detyrimit total ndaj firmës së ndërtimit. Sipas deklarimeve të vetë personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, znj. A.D., rezulton se ajo ka shlyer në total sipërmarrësin në vlerën e apartamentit në shumën prej **94.000 euro** (duke argumentuar dhe burimin e të ardhurave për këtë shumë). Pra në vitin 2010 është shlyer shuma totale prej **94.000 euro**. Ka mospërputhje midis deklarimit të ccmimit të blerjes së apartamentit në Deklaratën Vetting me ccmimin e paguar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Në lidhje me diferencën në çmim që rezulton nga blerja e apartamentit subjektit, me anë të pyetësorit të dërguar me *email në* datën 13.03.2018, i është kërkuar për personin e lidhur, znj. A.D., që të argumentojë si e ka marrë diferencën e çmimit të apartamentit në vlerën 20.000 euro, nga subjekti shitës dhe kur e ka marrë atë?

Personi i lidhur, znj. A.D., në përgjigjen e pyetësorit me nr. *** prot., datë 19.03.2018, është shprehur se: *“Sqaroj se personi i lidhur, znj. A.D., diferencën prej 20.000 eurosh, e ka marrë cash nga subjekti shitës, shoqëria “***” sh.p.k., në momentin që kam lidhur kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2013”*.

Nga deklarimet në vite personi i lidhur nuk e ka deklaruar kurrë marrjen e këtyre shumave dhe as disponimin *cash* të tyre. Kjo shumë e rikthyer dhe e marrë në dorëzim nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk përmendet as në Deklaratën-Vetting, as në deklaratën periodike vjetore. Lidhur me këtë pasuri nuk është përmbushur detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të

²⁶ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar UKT-së.

pasurive të kaluara tek subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit 32, pika 4, ligji nr. 84/2016. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë në kuptim të nenit 61 të po ligjit nr. 84/2016 .

Në përfundim të hetimit, vërehet se për shumën e pa deklaruar prej 20000 euro të marrë cash nga subjekti ndërtues “**” sh.p.k, ka :**

↓ Deklarim të pamjaftueshëm. Personi i lidhur nuk ka deklaruar marrjen cash të shumës prej 20.000 eurosh, nga subjekti shitës i pasurisë, që rezultoi si pasojë e blerjes së një apartamenti tjetër, jo atë të porositur.

➤ **Nga hetimi administrative i kryer nga Komisioni, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ka rezultuar se:**

Në llogarinë bankare të personit të lidhur, znj. A.D., janë bërë pagesa në mënyrë periodike nga marrëdhënie qiraje nga z. M.D. dhe nga subjekti “****”. Për këto pagesa, personi i lidhur nuk ka deklaruar asgjë në vite. Për këtë arsye është pyetur subjekti nëpërmjet pyetësorit shtesë me email-in e datës 06.02.2018, ku i është kërkuar: *“Në llogarinë e personit të lidhur, znj. A.D., në “Raiffeisen Bank”, gjatë vitit 2012 janë arkëtuar 5 këste prej 600 eurosh, qira nga z. M.D. Ndërsa për periudhën Maj 2013 – Qershor 2014, janë arkëtuar për 14 muaj, shuma prej 500 eurosh, nga shoqëria “****”. Ju lutem shpjegoni pse këto shuma nuk janë deklaruar më parë, për cilën pasuri janë derdhur këto shuma dhe dokumentoni pagesën e tatimit në burim”.*

Subjekti është përgjigjur me shkresën, nr. *** prot., datë 12.02.2018, sipas të cilës personi i lidhur me subjektin është përgjigjur: *“Me kontratën e porosisë të datës 19.11.2009, nr. *** rep., nr. *** kol., unë kam marr një apartament në katin *** në adresën: Blv. “****”, pas përfundimit të tij, pashë se nevojat e mia familjare i plotësonte më mirë apartamenti ngjitur me të, në të cilin në këtë kohë e kishte prenotuar një person tjetër. Gjatë kësaj kohe kontaktova me personin që kishte prenotuar apartamentin e mësipërm, dhe ramë dakord që të bënim shkëmbimin e këtyre apartamenteve, në momentin kur të bënim kontratën e shitblerjes, duke bërë kalimin direkt të pronës. Ky fakt vërtetohet me kontratën time të shitblerjes të datës 13.11.2013, nga ku rezulton se kam blerë apartamentin tjetër. Gjatë kësaj periudhe nga prenotimi deri në shitblerje unë nuk kam banuar në apartamentin e prenotuar, prandaj me kontratën e datës 10.04.2012, ia kam dhënë me qira z. M.D., i cili ashtu siç pretendoni ju, ka paguar 5 këste në shumën 600 euro, si dhe tatimin në burim që është detyrimi i tij ligjor.*

*Më datë 03.06.2013, kam lidhur kontratë qiraje po për këtë apartament me shoqërinë “****” sh.p.k., e cila ka derdhur në llogarinë time shumën prej 500 eurosh, për 14 muaj, ka paguar dhe tatimin në burim, që është detyrim i tij ligjor, gjë që pasqyrohet dhe në kontratën e qirasë. **Theksoj se, pagesa e kësaj shoqërie në llogarinë time është bërë dhe pas tjetërsimit të apartamentit, pasi sipas kushteve ligjore qiramarrësi vazhdon përdorimin e objektit sipas afatit të kontratës. Për këto veprime jam marrë vesh me palën që kam shkëmbyer pronën.***

Theksoj se në lidhje me këto të ardhura, unë nuk kam deklaruar më parë qiranë e marrë, kjo nga pakujdesia ime, duke menduar se detyrimi i tatimit në burim është bërë nga pala qiramarrëse dhe kaq e kam konsideruar të mjaftueshme. Sqaroj se duke qenë e pasqyruar në llogarinë time kjo shumë, lehtësisht e verifikueshme, unë nuk kam pasur asnjë interes për të mos e deklaruar këtë shumë përveçse neglizhencës sime”.

Për sa më sipër, personi i lidhur nuk ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qiradhënies me z. M.D. dhe shoqërinë “***” sh.p.k. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të hetimit vërehet se ka:

↓ Deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia.

- Me pyetësin shtesë të dërguar, më datë 13.03.2018, është pyetur subjekti në lidhje me shpenzimet për mobilimin e apartamentit të personit të lidhur, znj. A.D..

Subjekti në përgjigjet e pyetësit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 19.03.2018, argumenton se: *“Personit të lidhur, znj. A.D., mobilimi i apartamentit i ka kushtuar rreth 15.000 euro, mobilim i cili është bërë në vitin 2013”.*

Ky fakt nuk është deklaruar si shpenzim i kryer në vitin përkatës si dhe nuk është dhënë burimi i përdorur për realizimin e këtyre shpenzimeve. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e këtyre parave. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- ↓ Personi i lidhur, znj. A.D., nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013 shpenzime për mobilimin e apartamentit në vlerën 15.000 euro, për pasojë ka deklarim të pamjaftueshëm.
- ↓ **Burimi i krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.**

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar, si vijon:

- Në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” të vitit 2009, depozituar pranë ILDKPKI-së, më datë 30.03.2010, personi i lidhur ka deklaruar: *“Prenotim apartamenti, me sipërfaqe **99 m²**, me çmim total në shumën **94.000 euro**. Paguar kësti nga huaja e marrë nga kushëriri në shumën 40.000 euro. Në pjesën e të dhënave konfidenciale është deklaruar huaja e marrë nga kushëriri për prenotim apartamenti, vetëm huaja e z. Sh.D. sipas kontratës me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 19.11.2009”.*

- Në “Deklaratën e Pasurisë, të vitit 2010, personi i lidhur deklaroi se: “Për vitin 2010 ka paguar këstin e dytë dhe të fundit për shtëpinë”. Burimi për këto shuma është justifikuar nga personi i lidhur: Shumën prej **23.000** eurosh, e ka nga bashkëshorti, shumën prej **5.000** eurosh nga babai, shumën prej **6.000** eurosh (pakësim i gjendjes *cash* të deklaruar më parë) **dhe pjesa tjetër nga huaja e marrë nga kushëriri**. Ndërkohë që deklarohet se për 2010 shlyhet shuma prej **54.000** eurosh.

➤ **Burimet financiare të deklaruara për pagesën e apartamentit sipas deklaramit të vitit 2009 + 2010:**

Shuma 23.000 euro të ardhurat e ish-bashkëshortit (Nuk disponohet dokument).

Deklaruar të ardhura nga emigracioni në Greqi);

Shuma 5.000 euro nga babai;

Shuma 6.000 euro nga gjendja e akumuluar *cash*.

Shuma 20.000 euro + 36.000 euro huatë.

Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave për 2 huatë e marra nga znj. A.D., personave, z. Sh.D. dhe z. M.L., Komisioni ka bërë hetime për të verifikuar nëse këta persona kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për të dhënë hua pa interes, statusi i të cilave, sipas deklaramit të personit të lidhur janë akoma të pashlyera.

- **Hua në shumën prej 36.000 eurosh**, sipas kontratës, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, marrë²⁷ z. Sh.D. (kushëriri), pa interes.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Huaja e deklaruar nga personi i lidhur, znj. A.D., rezulton akoma e palikuiduar. Ndërkohë që në kontratën e huadhënies, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, është referuar që afati i kësaj kontrate është për 3 vjet, deri më datë 19.11.2012. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo hua nuk është shlyer ende nga personi i tij i lidhur, znj. A.D.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve²⁸, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2017, informon se shtetasi Sh.D., i datëlindjes 23.12.1955, rezulton i regjistruar me NIPT ***.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.01.2018, informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezulton se z. Sh.S.D., është i regjistruar me NIPT ***, me emër subjekti tregtar “****” (***), me administrator z. Sh.D., me datë regjistrimi 27.09.2010. Subjekti

²⁷ Subjekti i ka bashkangjitur deklaratën kontratë e huadhënies, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, për shumën 36.000 euro.

²⁸ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 07.12.2017, drejtuar DPT-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi të dhëna tatimore (të ardhurat, fitimet, humbjet dhe çdo lloj veprimi që përbën të dhënë tatimore), për z. Sh.D., në cilësinë e personave të tjerë të lidhur (sipas përkufizimit të ligjit nr. 84/2016).

ka kaluar në status pasiv më datë 19.12.2014. Për periudhën deri në fund të vitit 2010, subjekti ka bërë deklaramë me 0 (zero).

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.01.2018, informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezulton se:

- Z. Sh.S.D., është i regjistruar me NIPT ***, me aktivitet në fushën e avokatisë si person fizik. Për periudhën 1995 - 2008 , z. Sh.D., sipas të dhënave të verifikuara nuk bën shpërndarje dividendi. Subjekti është çregjistruar, më datë 30.05.2008;
- Z. Sh.D., është aksioner individ me 100 % të aksioneve të shoqërisë “****” sh.p.k., i regjistruar pranë organeve tatimore, më datë 10.01.2008. Subjekti ka deklaruar fitime ndër vite por ka shpërndarë dividend sipas vendimit të ortakeve vetëm në vitin 2014, në shumën 1.000.000 lekë;
- Z. Sh.D., rezulton dhe aksioner në shoqërinë “****” sh.a;
- Ortak i shoqërisë, “****” sh.p.k.;
- Ortak i shoqërisë, “****”;
- Anëtar i këshillit mbikëqyrës në disa shoqëri të tjera, por në asnjë prej këtyre bizneseve nuk ka tërhequr dividend.

Sipas këtyre të dhënave, **ky shtetas nuk ka pasur burime të ligjshme për të dhënë huan prej 36.000 eurosh.**

Marrëdhënia e huadhënies ndërmjet z. Sh.D. dhe personit të lidhur me subjektin, znj. A.D., u konfirmua dhe nga ky i fundit, sipas deklaratës së dhënë në zyrat e Komisionit me procesverbalin e datës 22.05.2018, në zbatim të nenit 50/1 të ligjit nr. 84/2016.

Huaja u provua nga kontrata, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009,²⁹ dhe është konfirmuar nga z. Sh.D. (kushëri). Gjithashtu, ky i fundit deklaroi që kishte të ardhura të ligjshme, por ky fakt nuk u provua me dokumentacion mbështetës. Lidhur me këtë hua, nuk është përmbushur detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj nga ana e huadhënësit, në kuptim të nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- Huadhënësi, z. Sh.D., **nuk ka pasur burime të ligjshme**, për shumën e dhëna personit të lidhur për blerjen e apartamentit.
- Nga ana e subjektit të rivlerësimit, por edhe nga huadhënësi nuk u provua me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave për dhënie e huasë, në shumën prej 36.000 eurosh.

➤ **Hua në shumën 20.000 euro**, marrë në vitin 2009, nga z. M.L. (kushëri) pa interes.

²⁹ Subjekti i ka bashkangjitur deklaratës kontratë huadhënie, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, për shumën 36.000 euro.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Huaja e marrë nga z. M.L., nuk është formalizuar në një akt noterial, në momentin e marrjes së saj. Huaja e deklaruar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. A.D., sipas deklarimeve rezultojnë akoma e palikuiduar.

Sipas përgjigjeve të pyetësorit të protokolluar në Komision, me nr. *** prot., datë 19.03.2018, të subjektit të rivlerësimit, është depozituar deklarata noteriale, nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 25.07.2011, hartuar nga notere M.Ç., sipas të cilës, deklarohet se znj. A.D. ka marrë nga z. M.L. një shumë huaje prej 20.000 eurosh, në vitin 2009, për blerjen e një shtëpie banimi në Tiranë. Kjo deklaratë është hartuar në vitin 2011, me kërkesën e huadhënësit. Në deklaratë cilësohet, që kjo hua do t'i shlyhet huadhënësit deri në vitin 2018.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë³⁰, me shkresën, nr. *** prot., datë 27.12.2017, informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezultojnë se subjekti, z. M.L., është i regjistruar si person fizik me NIPT ***, me datë regjistrimi 28.06.2010.

Rezultojnë se ky subjekt është regjistruar pranë organit tatimor më vonë nga momenti kur ka dhënë hua, për pasojë nuk janë vlerësuar të ardhurat pasi nuk përbën interes për procesin e rivlerësimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.01.2018, informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezultojnë se subjekti është i regjistruar me NIPT ***, me emër M.L. dhe administrator M.L., me datë regjistrimi 28.06.2010. Subjekti ka bërë kërkesë për çregjistrim më datën 24.07.2015 dhe për periudhën deri në fund të vitit 2010, në lidhje me situatën financiare (të ardhura, fitime humbje), nuk ka bërë deklarime.

Shtetasi M.L., është regjistruar si person fizik me aktivitet, “Bar - Kafe”, nga periudha 28.06.2010. Rezultojnë se nga ky aktivitet tregtar nuk ka deklaruar fitim për këtë periudhë. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna tatimore apo të dhëna mbi të ardhura apo burime financiare të mjaftueshme për vitin 2010, për të justifikuar huanë e dhënë në vitin 2010 prej 20.000 eurosh.

Drejtoria e Rajonale Tatimore Fier³¹, me shkresën, nr. ***, datë 16.04.2018, shpjegon se z. M.L., rezultojnë aksioner i subjektit “***” sh.p.k., me NIPT ***, me objekt veprimtarie: “Ndërtim i rrugëve”. Sipas të dhënave të kësaj shkrese konfirmohet se subjekti nuk ka shpërndarë asnjëherë dividend.

Lidhur me këtë hua, nuk është përmbushur detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj nga ana e huadhënësit, në kuptim të nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Nisur nga këto të dhëna Komisioni arrin në

³⁰ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 07.12.2017, drejtuar DPT-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi të dhëna tatimore (të ardhurat, fitimet, humbjet dhe çdo lloj veprimi që përbën të dhënë tatimore), për z. M.L., në cilësinë e personave të tjerë të lidhur (sipas përkufizimit të ligjit nr. 84/2016).

³¹ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 13.03.2018, drejtuar DPT-së, me të cilën është kërkuar informacion për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

konkluzionin se, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, z. M.L., në cilësinë e huadhënësit, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për huanë e dhënë personit të lidhur, znj. A.D.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- Huadhënësi, z. M.L., nuk ka pasur burime të ligjshme për shumat e dhëna personit të lidhur për blerjen e apartamentit.
- Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u provua me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave për dhënien e huasë, në shumën prej 36.000 eurosh.

Në lidhje me shumën prej 23.000 eurosh, të dhëna znj. A.D., nga ish-bashkëshorti, nga hetimi administrative ka rezultuar se, ish-bashkëshorti nuk ka konfirmuar faktin e mësipërm dhe rrjedhimisht nuk ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të kaluara tek subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza Financiare.

Raporti financiar për vitin **2009**, vit në të cilin është paguar kësti i parë i kontratës së porosisë për apartamentin në adresën: Rr. “***”.

	Personi i lidhur, A.D.	Viti 2009
1	Të ARDHURA	230.400
	Të ardhura nga paga	230.400
2	PASURI	5.692.668
3	SHPENZIME	160.714
	Shpenzime jetese	160.714
	Diferenca (1-4-5)	-5.622.982

Analiza financiare për vitin 2010

	Personi i lidhur, A.D.	Viti 2010
1	TOTAL TË ARDHURA	0
2	PASURI	7.892.952
	Likuidim total apartamenti, 54.000 euro	7.495.740
	Kursime	397.212
3	SHPENZIME	160.714
	DIFERENCA (1-2-3)	-8.053.666

Nga analiza financiare ka rezultuar se, znj. A.D., nuk ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për pasuritë e blera dhe shpenzimet e kryera për vitin 2009 - 2010.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- Deklarimi nga personi i lidhur për këtë pasuri është i pamjaftueshëm dhe i rremë dhe nuk është në përputhje me ligjin pasi nuk është shprehur diferenca prej 20.000 eurosh;
 - Nuk provon me dokumente dhe për pasojë nuk justifikon burimin, për shumën 23.000 euro, të dhëna nga z. G.L. (ish bashkeshorti) si para të fituara në emigracion, e për pasojë nuk janë burime financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri të blerë;
Huadhënësit Sh.D. dhe M.L., nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare në vitin që kanë dhënë huan e argumentuar se është përdorur për blerjen e këtij aseti;
 - Deklarim i pamjaftueshëm në lidhje me blerjen e pasurisë.
- j) Bashkëpronare në masën ¼, pjesë (25%) e pasurisë,³² me sipërfaqe 95.75 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurisë ***, Vol. ***, Fq. ***, (përfutuar nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore sipas vendimit, nr. ***, datë 06.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Sikurse është cituar më lartë, personi i lidhur është bashkëpronarë me subjektin e rivlerësimit. Trajtuar si çështje në paragrafin I. Pika 1.

ZVRPP Tiranë³³, me shkresën me nr. *** prot., datë 29.12.2017, konfirmon bashkëpronësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari me znj. A.D., për pasurinë me nr. ***, Vol. ***, Fq. ***, ZK. ***, lloji i pasurisë: Apartament, me sipërfaqe 95.7 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- ↓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

³² Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës:

- Kontratë shitblerje, nr. *** rep., *** kol., datë 26.04.1994, apartament me sipërfaqe 95.7 m², përfutuar nga privatizimi;
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 06.03.2007, me objekt: “Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë”;
- Vërtetim lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, me nr. *** prot., datë 07.12.2016;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 16.05.2007, për apartamentin me sipërfaqe 95.7 m², nga ku rezulton se z. Gani Dizdari, zotëron ¾ dhe znj. A.D., zotëron 1/4. pjesë.

³³ Shih në dosje, shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar ZQRPP-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari, dhe personave të lidhur me të.

- k) Bashkëpronare në ½ pjesë (50%) të pasurisë,³⁴ me sipërfaqe. 69.7 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurisë ***, Vol. ***, Fq. ***, përfituar nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore sipas vendimit, nr. ***, datë 06.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Sikurse është cituar më lartë, personi i lidhur është bashkëpronare me subjektin e rivlerësimit. Trajtuar si çështje në paragrafin I. Pika 2.

ZVRPP Tiranë³⁵, me shkresën me nr. *** prot., datë 29.12.2017, konfirmon bashkëpronësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari me znj. A.D. për pasurinë me nr. ***, Vol. ***, Fq. ***, ZK. ***, lloji i pasurisë: apartament me sipërfaqe 69.7 m² e ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë.

OSHEE³⁶, me shkresën me nr. ***, datë 06.02.2018, informon se referuar sistemit të faturimit identifikohet 2 kontrata me emrin e znj. A.D., njëra në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, me datë hapje në 10.10.1997.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- ↓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

- l) Autoveturë e blerë sipas kontratës së shitblerjes³⁷ me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **03.04.2013**, tip “Mercedes Benz”, në shumën **900.000** lekë, të siguruara nga konvertimi i makinës së mëparshme tip “Mercedes Benz”, në shumën 6000 euro duke i shtuar dhe shumën plotësuese të kontratës. Zotërim ,100% znj. A.D.

Burimi: Subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti, shumën e siguar nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “Mercedes Benz”, në shumën prej 6.000 eurosh, duke i shtuar dhe shumën plotësuese të kontratës.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

³⁴ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës:

- Kontratë shitblerje, nr. *** rep., *** kol., datë 09.02.1998, apartament me sipërfaqe 69.7 m², nga znj. D.D. në shumën 1.850.000 lekë;
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 06.03.2007, me objekt: “Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë”;
- Vërtetim lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, nr. *** prot., datë 07.12.2016;
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 05.06.2007, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m².

³⁵Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar ZQRPP-së, me të cilën është kërkuar informacion mbi pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari, dhe personave të lidhur me të.

³⁶ Shih në dosjen e subjektit shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 15.01.2018, drejtuar OSHEE-së.

³⁷ Subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës, kontratën e shitblerjes së automjetit, nr. *** rep., *** kol., datë 03.04.2013, për automjetin me targa ***, blerë në vlerën 900.000 lekë.

DPSHTRR, me shkresën me nr. *** prot., datë 12.01.2018, ka konfirmuar se automjeti me targën ***, është në pronësi të zj. A.D.

Regjistri Noterial³⁸, me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2017, informon se rezultojnë 2 akte noteriale të hartuara, tek noter I.H., në emër të znj. A.D., përkatësisht me datë shërbimi juridik 03.04.2013 dhe akt tjetër noterial me datë shërbimi 17.06.2013.

Noteri I.H., me shkresën protokolluar pranë Komisionit, më datë 22.01.2018, ka sjellë kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **17.06.2013**, për automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë ***, në vlerën **800.000** lekë, sipas të cilës znj. A.D. rezulton në cilësinë e shitësit të automjetit të saj të mëparshëm të tipit “Mercedes Benz” me targë ***.

Në “Deklaratën e Interesave Private Periodike” të vitit 2013 si dhe në vijim, rezulton që personi i lidhur, znj. A.D., nuk ka deklaruar se ka blerë automjetin me targë ***. Për herë të parë ky automjet është deklaruar në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, sipas shtojcës 2, ku argumentohet se: *“Me kontratën e blerjes, nr. *** rep., dhe *** kol., datë 03.04.2013, kam blerë autoveturën e tipit “Mercedes Benz” në shumën 900.000 lekë, të siguruara nga konvertimi i makinës së mëparshme të tipit “Mercedes Benz” në shumën 6.000 euro, duke i shtuar dhe shumën plotësuese të kontratës”*.

Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit (në dosjen e ILDKPKI-së) rezulton se, automjeti me targën ***, i tipit “Mercedes Benz”, është blerë nga znj. A.D. sipas kontratës së shitblerjes së automjeti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.04.2013. Ndërkohë, rezulton se znj. A.D., sipas përgjigjes së noterit I.H., me kontratën, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.06.2013, në cilësinë e shitëses, ka shitur automjetin e tipit “Mercedes Benz”, me targë ***. Pra, znj. A.D., e ka blerë automjetin me targë ***, përpara se të shiste automjetin e vjetër sipas deklarimit. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë në kuptim të nenit 61 të ligjit të nr. 84/2016.

Në përfundim të hetimit vërehet se:

- Deklarimi nga personi i lidhur për këtë pasuri është i rremë i pamjaftueshëm dhe nuk është në përputhje me ligjin;
- Nuk justifikohet burimi i të ardhurave për këtë pasuri sipas deklarimeve të dhëna nga personi i lidhur, sepse personi e ka blerë makinën përpara se të shiste automjetin e vjetër në pronësi të saj.

Deklarime të kryera nga personi i lidhur me subjektin - bashkëjetuesja:

Znj. Sh.K. (bashkëjetuesja), ka deklaruar këto pasuri:

- Depozitë në shumën³⁹ prej 135.048 lekësh, si rezultat i të ardhurave nga paga si mësuese;

³⁸ Shih në dosje shkresën e Komisionit, nr. *** prot., datë 12.12.2017, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë/ Zyrën e Regjistrimit Noterial, me të cilën janë kërkuar të dhëna mbi transaksione noteriale të raportuara në regjistër në emër të znj. A.D.

³⁹ Subjekti i ka bashkëngjitur Deklaratës -Vettig, vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, dega Tropojë, datë 28.10.2016.

- Disponim në *cash*, shumën prej 1.280.000 lekësh, të ardhura nga paga si mësuese për periudhën 1999 - 2013, nga puna e përkohshme në INSTAT, dega Tropojë dhe nga dhurimi i vëllezërve dhe nipave të saj.

Në lidhje me pasuritë e deklaruar nga bashkëjetuesja, në përfundim të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, vërehet se:

- Deklarimi përputhet me dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

1. Konsiderata të përgjithshme për pasurinë:

Nga analiza financiare e kryer rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në vitet 2007, 2008, 2012 dhe 2013 për pasurinë e krijuar si dhe shpenzimet e kryera. Për lehtësi tabela e mëposhtme:

		2007	2008	2012	2013
1	Pasuri	1.820.485	1.481.046	-833.640	725.524
	Blerë makinë tip “Mercedes Benz” (vajza)		760.529		
	Shitur makina tip Volksäagen (vajza)	0	-500.000		
	Kursime	1.820.485	1.220.517	-833.640	725.524
2	Detyrime	0	0	0	-700.000
	Hua kushëriri 20.000 euro				
	Shlyer detyrimi ndaj ndërtuesit për shtëpi, Gjiri Lalzit				-700.000
3	Pasuri neto (1-2)	1.820.485	1.481.046	-833.640	1.425.524
4	Shpenzime	560.000	475.407	2.894.824	895.767
	Shpenzim për rikonstruksion, banese Rr. “****”			2.664.250	700.000
	Shpenzime udhëtimi sipas <i>TIMS</i> dhe pyetësorit		153.978	69.860	35.053
	Shpenzime jetese	560.000	321.429	160.714	160.714
5	TE ARDHURA	1.926.227	1.921.634	1.770.016	2.039.260
	Të ardhura nga pagat e subjektit	1.859.200	1.833.234	1.680.672	1.947.841
	Të ardhura nga pagat vajza	67.027	88.400	0	0
	Interesa bankare			89.344	91.419
	Diferenca e pambuluar (5-3-4)	-454.258	-34.818	-291.169	-282.031

2. Përfundime lidhur me vlerësimin pasuror.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e pasurive:

- Apartament banimi,⁴⁰ me sipërfaqe 69.7 m², ndodhur në adresën: Rr. “****”, Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurisë ***, Vol. ***, Fq. ***;

⁴⁰ Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëngjitur Deklaratës-Vetting:

- Depozitë në shumën 5.272 euro;
- Shuma 23.000 euro, e dhënë nga z. G.L. (ish-bashkëshorti i znj. A.D.);
- Shuma 36.000 euro, hua nga z. Sh.D.;
- Shuma 20.000 euro, hua nga z. M.L.;
- 5 këste në shumën prej 600 eurosh, qira nga z. M.D.;
- 14 këste në shumën prej 500 eurosh, qira nga shoqëria “****” sh.p.k.;
- Shuma 15.000 euro, shpenzime për mobilimin e apartamentit;
- Autoveturë e blerë për shumën 900.000 lekë (nëntëqind mijë).

Për sa më sipër, nga konstatimet e Komisionit, përbën deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe shkak ligjor për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, me nr. *** prot., datë 07.05.2018, nr. *** prot., datë 11.05.2018, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

Nga hetimi i zhvilluar nga Komisioni ka rezultuar se, subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me shtetasin A.L./B. Z. A.L. cilësohet si person i përfshirë në krimin e organizuar, sepse sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. ***, datë 22.06.2012, është dënuar me vendim të formës së prerë⁴¹, për veprën penale të: “*Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 2 i Kodit Penal, vepër e cila të kualifikon si person të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016⁴² dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale⁴³. Ka rezultuar nga hetimi administrativ, që ndikimin e paligjshëm, z. A.L., e ka ushtruar ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë, në periudhën kur subjekti i rivlerësimit, z. Gani

-
- Kontratë shitblerje, nr. *** rep., *** kol., datë 09.02.1998, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m², blerë nga znj. D.D., në shumën 1.850.000 lekë;
 - Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 06.03.2007, “Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë”;
 - Vërtetim lëshuar nga ZVRPP-së Tiranë, me nr. *** prot., datë 07.12.2016;
 - Certifikatë për vërtetim pronësie datë 05.06.2007, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m².

⁴¹Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 08.04.2014, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me nr. ***, datë 22.06.2012.

⁴²Neni 3, pika 15, ligji nr. 84/2016.

15. “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.”

⁴³Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjykon:

a) Krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e.

Dizdari, ushtronte funksionin e gjyqarit pranë kësaj gjykate. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore, ka rezultuar që z. A.L., është dënuar për ndikim të paligjshëm ndaj vetë subjektit të rivlerësimit.

Nga verifikimi i raporteve të sistemit *TIMS*, ka rezultuar se, subjekti i rivlerësimit ka kaluar kufirin 10 herë me automjetin me targë ***, për periudhën 06.05.2013 - 14.07.2017. Sipas shkresës së **DPSHTR-së**⁴⁴ me nr. *** prot., datë 12.01.2018, informohet se automjeti me targë ***, është në pronësi të shtetasit A.Q.B./L. Nga vlerësimi i sistemit *TIMS* ka rezultuar se me automjetin në pronësi të z. A. L. ka udhëtuar 10 herë dhe më shumë se me çdo automjet tjetër.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit z. Gani Dizdari, është pyetur me pyetësorin e dërguar me *email-in* e datës 13.03.2018, me përmbajtje: “Çfarë marrëdhënie keni me personat A.L.? Tregoni sa të shpeshta janë takimet tuaja me këta persona? Ju lutem, specifikoni a keni udhëtuar ndonjëherë jashtë kufirit me këta persona? Nëse po, sa herë dhe me çfarë qëllimi?”

Subjekti në përgjigjen e ardhur me shkresën, nr. *** prot., datë 19.03.2018, informon se: “Z. A.L. e kam nip, djalë motre. Me të kam marrëdhënie të mira, kam pasur dhe kam takime jo vetëm në raste familjare por dhe në takime të veçanta sipas rastit. Me z. A.L. kam udhëtuar, jashtë shtetit në Hamburg - Gjermani, fillimisht në vitin 2010 kur kam shkuar për ndërhyrje shëndetësore e më vonë dhe 2 - 3 herë të tjera, po për arsye shëndetësore mbasi kam pasur detyrim të bëj kontroll mjekësor për çdo vit. Theksoj se, fakti që kam shkuar me nipin tim, z. A.L., është se ai ka jetuar rreth 15 vite në Hamburg - Gjermani”.

Kjo lidhje e ngushtë që subjekti ka me këtë person, përbën rrethanë që merret parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm⁴⁵ në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa i përket rrethanave lehtësuese, ato mungojnë sepse marrëdhënia familjare midis personave të mësipërm nuk është e largët dhe kontaktet familjare nuk janë të rralla.

Nisur nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Kjo përbën një problem serioz me figurën, që bën të pamundur vazhdimin e detyrës dhe konstituon shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra⁴⁶.

PËR KËTO ARSYE,

⁴⁴ Shih në dosje shkresën e Komisionit me nr. *** prot., datë 03.01.2018, drejtuar DPSHTR-së, me të cilën është kërkuar informacion për automjetet me të cilat ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit.

⁴⁵ Neni 38, pika 4, shkronja “ç”, të ligjit nr. 84/2016

4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar:

ç) Subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

⁴⁶ Neni 61, pika 2, ligji nr. 84/2016.

Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste:

2. “Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 16.07.2018.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Relator
Roland ILIA

Kryesues
Pamela Qirko

Anëtar
Olsi Komici

Sekretare Gjyqësore
Olsida Goxhaj